

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues për të mitur të përbërë nga gjyqtarja Kymete Kicaj, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarit profesionist Skender Çoçaj, gjyqtarëve porot Adnan Zhëllta, Sadife Arënliu dhe Arife Begaj anëtarë, me sekretaren juridike – procesmbajtësen Besnike Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. S. nga fsh., Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1.1 të KP-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.185/2015, të dt.30.07.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në seancë jo publike, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Nazan Shero, të akuzuarit Sh. S. dhe mbrojtësit të autorizuar të tij av. E. K., zyrtares nga Njësia për Mbrojtjen e Viktimave – Shemsa Sagdati, përfaqësuesi i palës së dëmtuar M. B. – av. Sh. B. dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar Sh. K. – av. R. K., me datë 24.06.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH. S., nga i ati M., e ëma H., e lindur M., i lindur më datë ..., në fsh., Komuna e Suharekës, tani me banim në Suharekë, i martuar, baba i një fëmiu, ka të kryer shkollën e lartë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të neni 364 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPP-së.

L I R O H E T N G A A K U Z A

- I. Se me datë 09.06.2015, pas orës 20:00, në Suharekë, në motelin “V. A.”, kryen aktin seksual me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në atë mënyrë pas takimit të tij me të dëmtuarat Sh. K. dhe M. B. në diskotekën e tij “D. M.” në Suharekë, dhe pas marrëveshjes rreth takimit, shkon në fshatin R. në hotelin “V. A., dhe duke shfrytëzuar situatën e pa mbrojtur dhe moshën e tyre, hynë në dhomën e të dëmtuarave dhe në prezencë të dëmtuarës M. B., kryen aktin seksual me të dëmtuarën Sh. K. e lindur me

Kësodore kishte për të kryer veprën penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nën paragraf 1.1 të KP-së.

- II. Se me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin nën I duke shfrytëzuar situatën e pambrojtur dhe moshën e të dëmtuarave, të pas kyerjes së aktit seksual me të dëmtuarën Sh., kryen aktin seksual edhe me të dëmtuarën M. B., e lindur me

Kësodore kishte për të kryer veprën penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nën paragraf 1.1 të KP-së.

- **Nga se nuk është provuar se i akuzuari i ka kryer dy vepra penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nën paragraf 1.1 të KP-së.**
- **E dëmtuara M. B., nga fsh., K. Suharekës dhe e dëmtuara Sh. K., nga fsh., K. Suharekë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.**
- **Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.**

A r s y e t i m

Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për të Mitur, ka parashtruar kësaj gjykate aktakuzë PP.nr.185/2015, të dt.30.07.2015, kundër të akuzuarit Sh. S. nga fshati, Komuna e Suharekës, për shkak të dy veprave penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1.1 të KP-së.

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti për të Mitur, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12.08.2015, kurse i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për dy veprat penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1.1 të KP-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar para shqyrtimit të dytë mbrojtësi i të akuzuarit av. S. M., me datë 26.08.2015, paraqiti propozim për hudhjen e aktakuzës konform nenit 250 paragraf 1 nënparagraf 1.4 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ngase në këtë çështje nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Gjykata caktoi shqyrtimin e dytë me datë 14.09.2015. Pas shqyrtimit të kërkesës për hudhjen e aktakuzës të parashtruar nga mbrojtësi i autorizuar i të akuzuarit i është dhënë mundësia Prokurorit të Shtetit të përgjigjet me shkrim apo gojarisht.

Prokurori i Shtetit në seancën e shqyrtimit të dytë ka kërkuar që kërkesa për hudhjen e aktakuzës të refuzohet si e pabazuar dhe lidhur me këtë çështje të zhvillohet shqyrtimi gjyqësor. Gjykata duke vepruar konform dispozitave të KPP-së dhe rrjedhës së kësaj çështje pas ndërmarrjes së gjitha veprimeve ligjore ka kaluar në fazën e shqyrtimit gjyqësor.

Shqyrtimi gjyqësor, provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor,

Në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari ka ngelur pranë deklaramit të mëparshëm lidhur me fajin duke mos pranuar fajësinë lidhur me veprat penale për të cilat ngarkohej sipas aktakuzës së lartcekur, dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me prezentimin e provave dhe atë:

- Deklarimi i dëshmitares R. K., dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 18.11.2015.
- Shiqimi i CD me deklarin e të dëmtuarës Sh. K. dhënë në Stacionin Policor me dt. 17.06.2015, dhe inqizimin e deklaratës së të dëmtuarës M. B. dhënë në Stacionin Policor në Prizren 18.06.2015.
- Leximi në ekstraktin e lindjes për Sh. K. lëshuar në Prizren me dt 29.07.2015 me nr. serik E
- Shiqimi në kopjen e pasaportës për të dëmtuarën M. B. lëshuar nga MPB me numër ...
- Leximi i raportit të ekzaminimit mjekësor lëshuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë me numër të referncës DML: MP15-038, të datës 24.06.2015, për të dëmtuarën Sh. K..
- Leximi i raportit të ekzaminimit mjekësor lëshuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë me numër të referncës DML: MP15-039, të datës 24.06.2015, për të dëmtuarën M. B.
- Leximi i procesverbalit të mundësisë hetuese të veqantë PPr.nr.146/2015 të dt.26.06.2015, marrja e deklaratës nga e dëmtuara M. B..
- Leximi i procesverbalit të mundësisë hetuese të veqantë PPr.nr.146/2015 të dt.29.06.2015, marrja e deklaratës nga e dëmtuara Sh. K.
- Deklarimi i dëshmitarit Sh. M. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 23.12.2015.
- Dëgjimi i dëshmitarit F. Sh. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 23.12.2015.
- Deklarimi i dëshmitarit M. H. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 23.12.2015.
- Dëgjimi i dëshmitarit A. H. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 29.01.2016.
- Dëgjimi i dëshmitarit M. K. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 29.01.2016.
- Deklarimi i dëshmitarit F. C. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 29.01.2016
- Deklarimi i dëshmitarit Sh. B. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 29.01.2016.
- Leximi i shkresës zyrtare të IPK-së, të dt.16.02.2016, me numër të referencës 160216/LK.
- Leximi i raportit të IPK-së, me nr. IPK/DH/83/15/VP të dt. 19.06.2015.
- Dëgjimi i dëshmitares S. A. dhënë në shqyrtimin gjyqësor në seancën e datës 13.05.2016.

Deponimet e dëshmimeve nga të dëmtuarat dhe dëshmitarve tjerë.

Nga dëshmitë e deponuara lidhur me këtë qështje penale fillimisht do të paraqitet dëshmia e të dëmtuarës **M. B.** dhënë në seancën e mundësisë së veçantë e cila ka deklaruar se natën kritike me 09.06.2015 po mbahej mbrëmja e semimaturës e gjeneratës së saj por e njejta ka qenë e përjashtuar nga procesi mësimor dhe drejtori i shkollës ku ajo kishte ndjekur mësimet nuk e kishte lejuar për të marrë pjesë në atë mbrëmje të organizuar nga shkolla si e papërshtatshme për shkak të sjelljeve të mëparshme të saj, andaj ajo kishte shkuar në një kafiteri në Suharekë e që quhej "D. M.", më pas ajo ka cekur se aty është takuar me Sh., e cila e kishte filluar bisedën me të duke e pyetur se ku e ke blerë këtë fustan, pastaj Sh. i kishte thënë "se a ikim nga shtëpia dhe jetojmë së bashku, se e kam një banesë në Suharekë por momentalishtë aty është duke qëndruar te zja ime" më pas ato ishin larguar në "D. M." në drejtim të motel "V. A." me qëllim për ta kaluar natën atje. Më tutje në dëshminë e saj ka shtuar se në atë motel kanë marrë një dhomë të përbashkët dhe derën e kanë lënë të hapur, ndërsa të nesërmen (që i bie të jetë data 10 qershor 2015) ka thënë se ka ardhur Sh., për të cilin ka thënë se nuk e ka njohur më parë, dhe nuk e ka ditur se kush e ka thirrë Sh. që të vij aty. E dëmtuara M. ka theksuar se posa Sh. ka hyrë në dhomën e tyre të atij moteli ku ishin duke fjetur ai menjëherë ka rënë në shtrat me to gjegjësishtë është futur në mes të dyjave dhe është kthyer kah ana e Sh. të njejtën ka filluar të përqafoj e më pas edhe të kryej marrëdhënie seksuale ndërsa kjo është larguar pak sa duke u ulur në një karrike afër derës së banjos, ka shtuar se Shefkiu pasi që e ka kryer aktin seksual me Sh. të njejtës ia kishte dhënë 20 euro, ndërsa më pas kryen aktin seksual edhe me këtë. Pas kësaj Sh. i kishte përcjellë që të dyjat me veturë që nuk ishte e tij, sipas të dëmtuarës vetura kishte ngjyre hiri të mbylltë dhe i kishte lënë në një rrugicë afër "B".

Ndërsa në stacionin policor përveq atyre që është cekur më lartë aty kishte mohuar të ketë pasur marrëdhënie seksuale me Sh. thotë se ai ka pasur marrëdhënie seksuale vetëm me Sh., në tregimin e saj ajo përshkruan në tërësi për të gjitha ditët e kaluara jashtë shtëpive të tyre, duke bërë me dije se kanë qëndruar së bashku me Sh. në vazhdimësi të shoqëruar me meshkuj të ndryshëm nëpër disa motele kryesisht në rrethin e Suharekës, ajo i ikën rrëfimit për të treguar se a ka pasur marrëdhënie seksuale me ndonjërin prej atyre meshkujve me arsyetim se ajo iu është dukur tepër e re për të pranuar ndokush që të ketë marrëdhënie me të.

E dëmtuara **Sh. K.** ka deklaruar se jeton në Itali me familjen e saj, dhe në Kosovë kishte ardhur për të kaluar disa javë pushimi, ku kishte qëndruar tek gjyshja dhe gjyshi i saj në fshatin ..., pasi kishte qëndruar disa ditë vendos të largohet nga shtëpia me pretekst se kinse do të shkoj tek dajhtë e saj në Shtimje, ajo vërtetë nuk kishte shkuar të dajhtë por kishte dalur në Suharekë dhe më pas qëndron në kafiterin "D. M." ku aty njoftohet me M., më tej ka shtuar se me dt. 09.06.2015 së bashku me M. kanë shkuar në motel "V. A." ku kanë marrë dy dhoma të veqanta dhe se ato kanë fjetur atë natë aty, por nuk iu ka ardhur askush në asnjërën dhomë, ka cekur se Sh. nuk e njeh, por e ka përmendur emrin e tij për shkak se atë natë kur i kishte zënë policia në motel "F." ka qenë e dehur dhe se ka pasur trysni nga një zyrtare policore me emrin S. për ta përmendur emrin e Sh. që sipas saj i kishte thënë "qite qet emër nëse don me shpëtu prej krejt kësaj" andaj ka theksuar se vetëm e ka përmendur emrin e tij pa e njohur dhe i pa bërë asgjë. Sh. më tutje ka deklaruar se pergjatë tërë atyre diteve sa ka qëndruar jashtë shtëpisë ka qëndruar nëpër motele të ndryshme së bashku me M., ndërsa shpenzimet i ka hequr M. por ka mohuar se gjatë këtyre ditëve të jetë shfrytëzuar seksualisht, nga ndokush.

Ndërsa në stacionin policor kishte deklaruar pothuajse të gjitha këto që ka cekur edhe në seancën e mundësisë hetuese të veçantë përveq se ka dhënë një version ndyshe sa i përket të akuzarit Sh. për natën kritike ku ka cekur se është vërtetë se në motel "V. A." atë natë (09.06.2015)

ka ardhur Sh. i cili ka pasur marrëdhënie seksuale me M., ndërsa ka cekur se mua vetëm më ka prekur në trup duke cituar "më ka prekur në vende ku prekin meshkujt".

Dëshmitarja **R. K.**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se Sh. e ka vajzë të djalit se ajo kishte ardhur nga Italia gjatë muajit Qershor, siç ka cekur dëshmitarja "për të më bërë hyzmet mua", ka vazhduar dëshminë e saj duke cekur se pas qëndrimit disa ditë në shtëpi Sh. e kishet pyetur se a të shkoj te dajhtë dhe me lejen e tyre kishte dalë nga shtëpia ka theksuar se i kujtohet se ka qenë ditë e marte dhe deri ditën e diel Sh. nuk ishte kthyer në shtëpi, të dielën dëshmitarja ka thënë se ka qenë te motra e saj në Suharekë, dhe përderisa po qëndronte te motra e kishte thirrë djali nga Itali (babai Sh.) e i kishte thënë shkoni merrne vajzën se është te një motel duke mos e ditur se për cilin motel bëhej fjalë dhe krejt në fund i bie ndërmend se emri i motelit ishte "V. F." ashtu e kishin informuar atë, dhe menjëherë ka cekur se ka shkuar ta lajmroj policinë, ku pas pak minutave policia e kishte sjellur në stacion Sh. por e kishin ndaluar për disa orë, e më pas e kishin dërguar në shtëpi, ka cekur se edhe njëherë tjetër ka ardhur policia dhe i ka marrë për ta intervistuar Sh. në Prizren, se kjo e ka pritur në një zyre ndaras nga ajo e ku merrej në pyetje Sh., dhe në fund ka shtuar se më askush nuk na ka ardhur në shtëpi, dhe nuk ka dëgjuar kurrë për Sh. S.

Dëshmitari **Sh. M.**, ka deklaruar se punon në motel "V. F." dhe ai motel është pronë e babait të tij, për natën kritike deklaroi se ka qenë në orar të punës dhe se i kujtohet mirë, se atë natë ka ardhë një veturë BMW e bardhë me targa të regjistrimit të Zvicrrës, se vozitësin e atij automjeti e ka njohur se kush ka qenë me të nuk ka mundur ta shoh sepse xhamat e veturës kanë qenë të errët dhe nuk ka mundur ti vërej, por nuk ka mohuar se atë natë në motel kanë qenë të dëmtuarat Sh. dhe M., se njerën prej tyre ka ardhur me pas policia dhe e ka marrë, ndërsa ka thënë se Sh. S. asnjëherë nuk e ka parë në motelin e tij për herë të parë e ka takuar në Gjykatë.

Dëshmitari **F. Sh.**, ka deklaruar se ka punuar si recepsionist në motel "V. A.", se punon me ndrrime (turne), njeri ndrrim fillon prej orës 07:00 të mëngjesit deri në ora 19:00 të mbrëmjes, ndërsa ndrrimi tjetër fillon nga ora 19:00 deri ora 07:00 e mëngjesit, i kujtohet se me dt.09.06.2015 ka qenë në ndrrimin e natës, dhe atë natë kanë patur vetëm katër musafir, ndër ta kanë qenë edhe dy vajza të reja, të cilat i kishte sjellur një veturë e që i kishte lënë me largë nga moteli, ato kërkuan një dhomë ndërsa thanë se nuk kishin para për ta paguar, në konsultim me shefin (M. K.) atyre ua kishte lejuar që të marrin një dhomë të përbashkët pa paguar me supozim se mund ti sjellin nesër paratë, pak me vonë ato kishin kërkuar edhe ushqim por edhe për ushqim nuk kishin pasur para, andaj dëshmitari ka theksuar se më janë dhimbsur dhe ua kam paguar dy pica, se kështu nuk ka vepruar asnjëherë më parë për mysafirët e motelit por këto nga që kanë qenë të reja, ua ka mundësuar, po ashtu ka shtuar se atë natë atyre vajzave nuk ju ka ardhur askush e as të nesërmen deri sa e kishte dorëzuar nderrimin kolegut të tij në ora 07:00 e mëngjesit, më tej ka thënë se të akuzuarin Sh. S. e njeh nga se shefi i tij e ka shok dhe vetëm njëherë e kishte parë në motel ku kishte ardhur së bashku me shefin e tij, dhe asnjëherë nuk ka sjellur ndonjë vajzë në atë motel.

Dëshmitari **M. H.**, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se ka punuar një kohë si recepsionist në motel "V. A.", ndërsa duke iu referuar natës kritike ka cekur se ka qenë në ndrrimin e pasdites, se atë natë në orët e vona në motel kishin ardhur M. me Sh. së bashku me A. B. dhe F. S., se ato kanë marrë dy dhoma, ndërsa pagesën e ka bërë F., ato e kanë kaluar natën në atë motel, por nuk kishte vërejtur nesë ndokush iu kishte ardhur atyre atë natë ngase sipas tij moteli ka dy hyrje dhe ekziston mundësia që të hyj ndokush e të mos vërehet nga personeli por ka treguar se në orët e hershme të mëngjesit atë e kishte zënë gjumi dhe kur ishte zgjuar rreth orës shtatë të mëngjesit ato vajza kishin dalur nga dhomat e motelit, ndërsa për të akuzuarin ka cekur se të njejtin e njeh vetëm

si figurë, se ishte shok me shefin e tij dhe se vetëm njëherë e kishte parë në motel dhe atë kishte ardhur se bashku me shefin për të bërë barazimin e pagesave.

Dëshmitari **A. H.** ka deklaruar se punon në kafiterin "A." në Suharekë, se me të akuzuarin është shoqëruar që nga shkolla e mesme dhe asnjëherë nuk i kanë ndërprerë kontaktet, ndërsa natën kritike rreth orës 19:30 - 20:00 ka cekur se janë takuar me Sh. në një bastore sportive që gjendet në rrugën e R. se aty kanë qenë edhe disa shokë të tjerë F. C., M. K. dhe Sh. B., se aty kanë qëndruar deri pas mesnatës, gjatë tërë kësaj kohe kanë qëndruar së bashku që të pestit më pas ka theksuar se ka shkuar në shtëpi dhe nuk ka pasur më kontakt atë natë me Sh.

Dëshmitari **M. K.**, ka deklaruar se të akuzuarin e njeh që nga e vitet 90-ta me të njëjtin ka shoqëri të mirë, madje së bashku kanë mbajtur me qera edhe kafiterinë e quajtur "D. M.", duke ndarë fitim përgjysmë, poashtu ka cekur se ka në pronësi të vetën edhe motel "V. A.", që gjenden në rrugën e fshatit R., ndërsa për natën kritike ka theksuar se janë takuar në lokalin e F. (bastore sportive), diku rreth orës 20:00 ka ardhur Sh. së bashku me Sh. B., sipas tij Sh. ia kishte kërkuar qelsat e veturës që ti dërgonte punëtorët e "D. M." në fshatin S., por Sh. i kishte thënë "se po i dërgojmë me veturën time", kështu që ata dy kishin shkuar me veturën e Sh. "Golf 5", karavan, ngjyrë hiri metalike dhe pas 30 minutave përsëri ishin kthyer aty, ku kishin vazhduar të pinin deri pas mesnate, më pas kishin shkuar në një kafiteri tjetër në fshatin K. deri në orët e hershme të mëngjesit, dhe ishin ndalur në S. P. kishin ngrënë ushqim rreth orës 05:00 - 06:00 ishin shpërndarë nëpër shtëpia. Ndërsa ka mohuar se atë natë e kishte thirrë puntori i tij nga motel villa aroma për ta pyetur se a do të lejoj që të qëndrojnë pa pagesë dy vajza të reja duke precizuar se me dt. 12.06.2015 punëtori i tij F. Sh. e kishte thirrë në telefon dhe e kishte pyetur se a mund të lejoj qëndrimin e dy vajzave në motel pa pagesë, ku ka cekur se ka lejuar që ato qëndrojnë pa pagaur edhe pse nuk e ka ditur se kush janë apo nga janë, poashtu ka theksuar se një gjë të tillë nuk e ka lejuar asnjëherë më parë, ndërsa Sh. nuk ka pasur dijeni se këto vajza janë duke qëndruar në atë motel.

Dëshmitari **F. C.**, ka deklaruar se me të akuzuarin njihet që nga paraluftra, me të njëjtin se herë pas here kishte rastisur që të luajnë futboll apo edhe që të pijnë kafe ndonjëherë, ndërsa për natën kritike rreth orës 20:00 ka deklaruar se janë tubuar në kafiterin e tij të quajtur "S. C." në Suharekë, fillimisht kishte ardhur M., ndërsa pas tij Sh., më pas Sh. dhe i fundit kishte ardhur A., aty kanë qëndruar deri pas mesnate ku më pastaj kishin shkuar në kafiterinë "A. C." në fshatin K., e më pas rreth orës 04:00 të mëngjesit janë ndalur në restaurantin e "S. P." në fshatin Sh. kanë ngrënë ushqim dhe në mëngjes rreth orës 06:00 janë shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre, këtë rrugëtim e kanë bërë me dy vetura njëra ishte e Sh. "Golf 5" karavan ngjyrë hiri metalike dhe me veturën e M. e tipit BMW ngjyrë e bardhë, ndër të tjera ka shtuar se Sh. atë natë ishte si qdo natë tjetër tek ai nuk ka vërejtur fare asnjë ndryshim në sjellje apo në disponim, se ata tërë kohën atë natë kanë qëndruar së bashku dhe nuk e ka parë nëse për pak kohë është larguar apo jo Sh.

Dëshmitari **Sh. B.**, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me Sh. ishte njohur gjatë kohës së luftës, me të njëjtin kishin qenë në të njëjtin njësit ushtarak, se me të është takuar edhe pas çlirimit se ndonjëherë kishin pirë kafe së bashku, ndërsa për natën kritike ka deklaruar se kishte shkuar rastesishtë në kafiterinë F. dhe aty kishin qenë edhe shokët tjerë duke pirë andaj kishte vazhduar të qëndroj me ta, ndërkohë Sh. ia kishte kërkuar qelsat e veturës së M. për ta dërguar dikend në fshatin S., por ka cekur "se unë i thashë të dërgoj me veturën time" pastaj së bashku me Sh. i kishin dërguar dy punëtorë të disco metit në fshatin S., e më pas ishin kthyer përsëri në Suharekë ku Sh. e kishte përsëri në lokal te F. ndërsa vet kishte shkuar që të pijnë një kafe me një shok tjetër në kafiterin "5." aty afër lokalit të F., me atë shok kishte qëndruar vetëm 30

minuta dhe më pas iu kishte bashkangjitur shoqërisë së mëparshme, deri pas mesnate kishin qëndruar në atë lokal, mandej kishin shkuar në fshatin K. në kafietrin "A. C." deri në ora 04:00, pastaj në restaurantin e "S. P." kishin ngrënë mëngjes dhe rreth orës 06:00 të mëngjesit të datës 10.06.2015 ishin shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre.

Dëshmitarja **S. A.**, ka deklaruar se Sh. e njeh që kur kanë filluar të punojnë si zyrtar policor nga viti 2003, se kanë punuar në të njëjtin Stacion Policor në Suharekë, se me të njëjtin kanë pasur raporte të mira kolegiale, më tutje thekson se ka qenë në orar të punës në mes të datave 16 dhe 17 qershor 2015, ka qenë në turnin e pasdites që fillon nga ora 23:00 deri në ora 07:00 e mëngjesit, më tutje ka deklaruar se atë natë posa kishte marrë ndrrimin, në stacion kishte ardhur një ankuesë me emrin R. K. e cila kishte lajmëruar se vajza e djalit të saj me emrin Sh. K. gjendej në motel "V. F.", dhe kërkonte që të shkonte patrulla e policisë në atë motel dhe ta merrte vajzën nga aty, me të marrë informatën dëshmitarja tregon se e njofton eprorin e saj rreshterin A. K., i cili i urdhëron zyrtarët policor që menjëherë të vepronin dhe të shkonin në atë motel për të verifikuar vendodhjen e asaj vajze që kërkonte ankuesja, më pas dëshmitarja ka thënë se së bashku me zyrtarin policor S. G. kemi shkuar në atë motel dhe kemi vërtetuar se aty gjendej Sh. K. së bashku me një person fshati G. B. N., dhe i kemi marrë që të dy i kemi sjellë në Stacion dhe kemi njoftuar sërish rreshterin se vajza që kërkonte ankuesja ishte e mitur dhe kemi kërkuar nga ai që të njoftohen njësitet përkatëse që merren me këto raste, ndërsa të dëmtuarën Sh. e kemi vendosur në një zyre të veqante në Stacion Policor në Suharekë, dhe për deri sa ishim duke qëndruar në koridor të stacionit së bashku me rreshterin A. K. dhe disa polic tjerë Sh. hap derën e zyrës ku ishte e vendosur dhe drejtohet duke na thënë "se në këtë rast është i involvuar edhe një polic", atëherë sqaron dëshmitarja se i thotë asaj "hyn mbrenda se nuk di ti asgjë" Sh. i kishte thënë "po e di ai polic e ka emrin Sh. dhe nëse ti nuk ndërmerrë asgjë, unë do ti tregoj djalit të hallës që është polic hetues në Prizren" pas këtij prononcimi të të dëmtuarës dëshmitarja tregon se rreshteri më ka kërkuar që të përpiloj një raport me shkrim të cilin edhe e kam përpiluar dhe ua kam dorëzuar organeve gjegjëse, ndërsa të dëmtuarën thotë ta këtë trajtuar si krejt rastet tjera të kësaj natyre, me të njëjtën kishte zhvilluar vetem një bisedë të lirë pa praninë e askujt tjetër, vetëm sa për ta qetësuar, dhe më pas diku pas orës 02:00 pas mesnate me veturë zyrtare e kanë dërguar në shtëpinë e babait të saj gjegjësisht tek prindrit e babait të saj në fshatin B., më tutje dëshmitarja ka cekur se duke pasur parasysh se për këtë rast ka qenë i njoftuar edhe rreshteri A. K. nuk e kam njoftuar as IPK e as njësitin policor për trafikim me qenie njerëzore ngase konsideroj se ka qenë detyrë e rreshterit që ta bëjë këtë.

Vlerësimi i dëshmive dhe provave tjera

Trupi gjykues me kujdes të veçantë ka trajtuar dëshminë e të dëmtuarës M. B., për faktin se e njëjta kishte edhe një histori tjetër po thuajse të ngjajshme me këtë. Gjatë dhënies së dëshmisë së saj shpeshëherë ajo ngatërrohej me faktet kryesore të çështjes duke mos ditur të gjej fillin e tregimit të nisur, për deri sa në polici kishte deklaruar se natën kritike Sh. kishte pasur marrëdhënie vetëm me Sh., në mundësinë hetuese të veçantë thotë se ka pasur edhe me të marrëdhënie seksuale, deklarimi i saj se atë natë në motel morëm vetëm një dhomë dhe e lam derën të hapur duke mos dhënë arsye bindese se përse e kanë lënë derën e dhomës se hapur, të nesërmen thotë se ka ardhur Sh. në ora 09:00 e mëngjesit, por nuk ka ditur të sqaroj se si e dinte Sh. se ato janë pikërisht në atë dhomë moteli, kush e ka thirrur atë, pasi që thotë se unë nuk e kam thirrë, ka mundësi që ta ketë thirrë Sh. Andaj duke pasur parasysh zbrastësitë, divergjencat, dhe hamendësimet që ka paraqitur kjo e dëmtuar, dëshmia inkrimuese e saj nuk mund të konsiderohet e besueshme.

Poashtu edhe dëshmia e të dëmtuarës Sh. K. ka shumë mangësi, ajo ndryshe e paraqet rastin gjatë marrjes në pyetje në polici e ndryshe deklaroi në mundësinë hetuese të veçantë, përderisa në polici pohon të jetë ngacmuar seksualisht nga i akuzuari Sh. S., në mundësinë hetuese të veçantë, ndryshon mendimin dhe deklaroi se atë nuk e ka njohur kurrë më parë, se me të nuk ka pasur asgjë, madje as M. thotë se nuk ka pasur me të marrëdhënie seksuale, por kërkon që të lirohet Sh. edhe pse ate nuk e njihte fare pra vrehet qartazi se e njëjta tani po merrte pozicion mbrojtës ndaj të akuzuarit, andaj në vlerësimin e besueshmërisë së një dëshmitare me një personalitet të tillë, dëshmia e saj nuk mund të trajtohet pa ndërlidhje me këta faktor, siq janë faktin e të qenurit minorene, pastaj ikja nga shtëpia, qëndrimi disa ditë nëpër motele dhe e shoqëruar nga meshkuj të ndryshëm, të gjitha këto rrethana janë marrë parasysh gjatë vlerësimit të dëshmisë së saj dhe në bazë të të gjithë këtyre indikatorve dëshminë saj e bëjnë jokredibile.

Nga dëshmia e dëshmitares R. K., nuk mund të nxjerrte ndonjë element inkriminues për të akuzuarin por nga dëshmia e saj mund të vërtetohet vetëm fakti se e dëmtuara Sh. K., ishte larguar nga shtëpia gjyshërve të saj për disa ditë me arsyetim se po shkonte te dajti e saj, dhe se natën kritike e kishte gjetur policia pikërisht në atë motel ku i kishte thënë edhe djali i saj përkatesisht babai i Sh., e për të cilën informatë i'u është drejtuar policisë.

Meqenëse dëshmitë e dëshmitarëve F. Sh., Sh. M. dhe M. H., pothuajse janë identike në përmbajtjen e tyre, gjykata i ka trajtuar bashkarisht që të tri dëshmitë, po të krahasohen dëshmia e dëshmitarit F. Sh. dhe e dëshmitarit M. H. vërehen diskrepanca të mëdha në deklarimet e tyre, ndërsa e përbashkëta e këtyre dëshmimeve është se që të tre punojnë si recepcionistë, F. dhe M. të motel "V. A.", ndërsa Sh. punonte të motel "V. F.", asnjëri nga ta nuk e kishte parë të akuzuarin Sh. me ndonjë femër në këto dy motele të cekura më lartë, që të tre thanë se nuk marrin shenime për të gjithë personat që qëndrojnë në këto motele, por marrin vetëm regjistrimin e veturave, që të tre pohuan se viktimat Sh. K. dhe M. B. kanë qëndruar në këto motele, madje në motel "V. A." ato nuk kishin paguar fare, ndërsa në motel "F." pagesën e kishte bërë një person mashkull që ishte në shoqëri me këto femra, andaj si të tilla këto dëshmi nuk japin ndonjë të dhënë lidhur me ndonjë veprim inkrinues për të akuzuarin.

Poashtu edhe dëshmitë e dëshmitarëve M. K., F. C., Sh. B. dhe A. H., gjykata i ka vlerësuar bashkarisht për faktin se dëshmitë e tyre pothuajse janë identike. Së pari duhet theksuar faktin se të gjithë këta dëshmitarë janë shokë të ngushtë të të akuzuarit, andaj është e kuptueshme që dëshmitë e tyre ishin të orientuar në mbrojtjen e të akuzuarit, të njëjtit kanë paraqitur pothuajse në mënyrë të njëjtë natën e dt.09.06.2015, me disa detaje mospërputhëse me deklarimet e njëri tjetrit për deri sa njëri deklaronte se Sh. u largua për pak nga lokali ku ishin duke qëndruar tjetri thoshte se për asnjë moment nuk u largua Sh., pra vrehet mirë tendenca e tyre për ta bërë më bindëse alibinë e paraqitur nga i akuzuari, gjykata konkludon se është e pritshme se dëshmitë e këtyre dëshmitarëve të ishin favorizuese për të akuzuarin, andaj si të tilla nuk jua fali besimin, nga se me këto dëshmi nuk është arritur të zbardhet asnjë rrethanë relevante për çështjen.

Dëshminë e dëshmitares S. A. trupi gjykues e vlerëson në përgjithësi si objektive, nuk kishte ndonjë zbrastësirë në dëshminë e saj, të gjitha ato që ka paraqitur në raportin me shkrim të njëjtat i ka përsëritur edhe në shqyrtimin gjyqësor, ajo ka treguar se nuk kishte asnjë lloj mërie apo inati ndaj të akuzuarit, se thjeshtë në rastin konkret e ka kryer punën e saj si zyrtar policor, dhe në këtë rast ka vepruar si në qdo rast tjetër. Se ishte e dëmtuara Sh. K. ajo që e hapi derën e zyres ku ishte duke qëndruar dhe pa e pyetur askush e përmendi emrin e Sh. të involvuar në këtë rast, këtë e kanë dëgjuar edhe disa kolegë tjerë që ishin prezent e jo që dëshmitarja të ketë bërë trysni tek e dëmtuara

qe ta përmendte emrin e Sh. Pra nga dëshmia e saj nuk jep ndonjë të dhënë që do ta mbështeste ndonjë veprim inkriminues të të akuzuarit.

Nga ekstrakti i lindjes për të dëmtuarën Sh. K. lëshuar në Prizren me datë 29.07.2015, me numër serik E ..., vërtetohet se e njëjta është e lindur me datë

Nga kopja e pasaportes për të dëmtuarën M. B., lëshuar nga MPB me numër P..., vërtetohte se e njëjta është e lindur me datë

Nga leximi i raportit të ekzaminimit mjekësor lëshuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë me numër të referencës DML: MP15-038, të datës 24.06.2015, për të dëmtuarën Sh. K., vërtetohet se e njëjta fare nuk ka pranuar që t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekësor.

Nga leximi i raportit të ekzaminimit mjekësor lëshuar nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë me numër të referencës DML: MP15-039, të datës 24.06.2015, për të dëmtuarën M. B., vërtetohet se te e njëjta nuk janë konstatuar dëmtime trupore të jashtme. Në ekzaminimin gjinekologjik mjeko-ligjor nuk janë konstatuar dëmtime në regjionin perineal dhe anal.

Nga shkresa zyrtare e IPK të dt. 16.02.2016, është vërtetuar se të njëjtit nuk kanë mundur të sigurojnë inqizime të shkarkuara nga kamerat e sigurisë në pompën e benzinës "S. P." për datën 09/10.06.2015, për shkak se regjistrimet e video incizimeve mund të ruhen vetëm dy javë.

Nga leximi i raportit të IPK-së me nr. IPK/DH/83/15/VP të dt. 19.06.2015, vërtetohet se të njëjtit kanë punuar rastin me dt. 19.06.2016 ndaj të dyshuarit Sh. S., zyrtar policor në SP Suharekë për shkak të dyshimit se i njëjti ka keqpërdorur seksualisht dy vajza të mitura dhe më tej ky raport përmban veprimet e ndërmarrura hetimore nga ky organ.

Mbrojtja e paraqitur nga i akuzuari Sh. S.

I akuzuari Sh. S. ka deklaruar se: qe nga viti 2000 ka punuar si zyrtar policor në Stacionin Policor në Suharekë. Poashtu ka theksuar se si ortak me M. K. e kanë mbajtur së bashku Kafiterinë "D. M." në qendrën zejtare në Suharekë edhe pse emrin e ka pasur disco, ajo në fakt ka qenë një kafiteri e rendomte. Ka theksuar se nata kritike pra dt. 09.06.2015 për të ka qenë një natë e zakonshme, se atë natë ka qëndruar së bashku me shokët e tij M., Sh., A. në bastoren sportive të cilën e mbante F. C., se atë natë u takuan ata rastësisht aty, dhe erdhen njëri pas tjetrit, për vete thotë të ketë shkuar diku rreth orës 19:00 aty, ndërsa rreth orës 20:00 është larguar nga aty për ta dërguar djalin e vllaut në fshatin S., se i ka kërkuar qelsat e veturës nga M. që ta dërgoj me veturën e tij, por Sh. i kishte thenë se po e dërgojmë me veturën time, dhe ashtu kishte vepruar. Pastaj ka thënë se ishte kthyer përsëri në bastore, ndërsa Sh. e kishte një punë diku tjetër për disa minuta më pas përsëri ishte kthyer në bastore – biliardo, ndërsa ka cekur se përsëri jam larguar nga bastorja diku rreth orës 21:30 minuta kam shkuar në "D. M." pasi që një numër i madh i nxënësve që kishin festuar semimaturën atë ditë kishin kërkuar që pasi të përfundojnë mbrëmjen e semimaturës të vazhdojnë ndejën në "D. M." andaj ju kishte kërkuar punëtorve që të punonin jashtë orarit, aty ka cekur se ka qëndruar vetëm 30 minuta, ka shtuar se aty e ka parë M. por nuk kishte ndërruar asnjë fjalë, ndërsa për Sh. thotë se as nuk e ka njohur dhe për herë të parë e kishte parë në seancën e mundësisë hetuese të veçantë, më tutje ka cekur se përsëri ka shkuar në të njëjtën bastore ku ishin duke qëndruar edhe shokët e lartcekur për të vazhduar që të luanin biliardo dhe të pinin diku deri pas mesnate në ora 01:30, me tutje ka shtuar se janë larguar nga aty, për vazhduar në një lokal nate

me muzikë të quajtur "A. C.", në fshatin K., aty kishin qëndruar deri në orët e hershme të mëngjesit, diku rreth orës 04:30 minuta, e më pas ndalen për të ngrënë ushqim në restaurantin e pompës së benzinës së quajtur "S. P." deri në ora 05:00 e me pas me veturen Sh. kishte shkyar në shtëpinë e tij ku thotë të ketë fjetur deri në ora 11:00 të asaj dite. Ndërsa për natën kur është gjetur Sh. K. ne motel "V. F." ka cekur se atë natë kur ajo ishte derguar në Stacion koincidon të jetë aty edhe një qiftë H. dhe A. D., të njohur të të akuzarit të cilët ishin aksidentuar po atë natë dhe në Stacion po prisnin që të jepnin deklaratat e tyre, ata i kishin treguar të akuzuarit se atë natë në Stacion e kishin dëgjuar të dëmtuarën që përmendte emrin e tij gjersa ndaj saj po ushtronin dhune dhe presion. Të nesërmen me datë 17.06.2015, i akuzuari thotë ta ketë filluar ditën si zakonishtë duke shkuar në punë para kohe prej 30 minutave si qdo here tjetër, se në trotuar para stacionit ka takuar Rreshterin A. K. dhe shefin e ndrrimit H. G. dhe i kishte pyetur se a kishte pasur diçka gjatë natës, por ata i kishin thënë se nuk ka pasur asgjë, e më vonë dikur rreth orës 10:00 të të asaj dite atë e kishte thirrur shefi i operativës A. B. dhe e kishte njoftuar se kishte një ankese për të, por i akuzuari thotë se nuk e kam marrë seriozisht nga se edhe më parë kishte pasur ankesa ndaj tij. Sipas versionit të të akuzuarit ka qenë një grup i kolegëve që nuk ka pasur raporte të mira me të, andaj ky grupacion janë munduar disa herë që të inskenojnë raste të kundërligjshme ndaj tij, por që kanë rezultuar të pasuksesshme, andaj ka theksuar se edhe në këtë rast ky grupacion kanë pasur ndikim te e dëmtuara Sh. dhe e kanë shtytur që të pranoj kinse e kam keqpërdorur seksualisht.

Përndryshe i akuzuari ka mohuar të ketë keqpërdorur seksualisht të dëmtuarat e mitura Sh. K. dhe M. B.

Deklarimet e palëve në fjalën përfundimtare.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke u bazuar në rrjedhën e shqyrtimeve gjyqësore, dhe administrimin e provave në të cilat është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale të keqpordorit seksual të personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1.1 të KP-së. Provat të cilët kanë vërtetuar kryerjen e veprave penale janë deklaramet e të dëmtuarave M. B. dhe Sh. K., të dhënë në polici e të cilat edhe janë marr me video-incizime, nga zyrtarja policore e trafikimit me qenie njerëzore në prezencën e mbrojtësit të viktimave dhe zyrtarit nga qendra për punë sociale, ku të dy të miturat kanë përshkruar ngjarjen e ditës kritike. Në deklaramet e tyre pohojnë se më dt.09.06.2015 kanë qenë në diskotekën "M." e pastaj natën kanë shkuar në motelin "V. A.", ku pas tyre – rreth orës 20:00 kishte shkuar edhe Sh., e për të cilin theksojnë se është polic në Suharekë. Deklarata këto që në tërësi përputhen mes veti. Derisa mospërputhjet e deklarimeve ku e dëmtuara M. B. ka theksuar se Sh. ka kryer aktin seksual me Sh. para syve të saj, derisa deklarimi i të dëmtuarës Sh. se Sh. ka kryer mardhënie seksuale me M. – janë deklarime ku viktimat mundohen të fshehin faktin se kanë pasur mardhënie seksuale duke ia mveshur atë njëra tjetrës, duke mos dashur të jenë në pozita të viktimave edhe përkundrejt faktit ku e dëmtuara Sh. është shprehur "ndihem pak vitkimë.. se Sh. më ka keqpërdorur duke më prek në trup – aty ku prekin meshkujt". Këto deklarime të të dëmtuarave janë marrë me dt.17.06.2015 dhe 18.06.2015, periudha kohore më e afërt pas kryerjes së veprës dhe para ndikimeve në të dëmtuara. E që si të tilla janë më të besueshme. Në deklarimin e të dëmtuarës M. B. dhënë në hetimin e veçantë, ajo vërteton faktin se kanë pasur mardhënie seksuale me Sh. që të dyja. E njejtë përshkruan edhe rrjedhën fillimisht të takimit me të akuzuarin Sh., e më pas se ata kanë shkuar në motelin "V. A." në fshatin R., dhe se në motel ka shkuar edhe Sh. Ka precizuar "nër sy meje kanë bo mardhënie seksuale". E në vazhdim pohon se edhe me të ka kryer aktin seksual.

Në fund të deklaratës së saj, ajo shprehet “du me dhon dorëheqje lidhur me rastin” duke shprehur dëshirën që të lirohet Sh.

Nisur nga fakti i deklarimit të saj ku ajo tregon se Sh. me të dy ka kryer marrëdhënie seksuale, kjo pasqyron gjendjen faktike të natës kritike, derisa fakti se don me dhon dorëheqje duke dëshiruar që i akuzuari të lirohet – tregon vetëm dëshirën e saj në drejtim të mbrojtjes së të akuzuarit Sh.

Në hetimin e veçantë e dëmtuara Sh. K. në tërësi mohon të gjitha ato që ka dhënë në polici dhe si i tillë është në vete kontradiktor.

- Në hetimin e veçantë ka deklaruar se nuk e njeh fare Sh., asnjëherë nuk e ka parë dhe tash me e pa nuk do ta kishte njohur derisa,
- në polici ka përmend Sh. në rastin e ngjarjes kritike – si polic në Suharekë, deklarim të cilën e vërteton edhe dëshmitarja S. A.,
- se në polici ka dhënë deklaratë nën ndikimin e alkoolit e në vazhdim ka precizuar se atë ditë kur janë zënë nga polici nuk kanë pirë, nga rrjedhë se në momentin kur janë marrë në pyetje në polici nuk kanë qenë nën ndikimin e alkoolit,

Në hetimin e veçantë ajo donë të tërhiqet nga deklaratat e saj të cilën e ka dhënë në polici duke shprehur se në polici nuk di se çka kam deklaruar, herë duke u arsyetuar se kam qenë nën ndikimin e policëve, e herë se kam qenë nën ndikimin e alkoolit.

Derisa nga shkresat e lëndës rezulton se deklaratat e të dëmtuarës Sh. K. dhënë në polici ka qenë pranë njësitit të hetimeve të trafikimit me qenie njerëzore në Prizren nga ana e policit hetues Sh. M., me video – incizimin, ku monitorues kanë qenë zyrtarja për mirëqenje sociale Rr. F. dhe mbrojtësi i viktimave të PSH – Prizren A. A., deklarime këto të orientuar në drejtim të mbrojtjes së të akuzuarit Sh. S.

I akuzuari Sh. S. mohon në tërësi kryerjen e veprave penale dhe çdo herë jep deklarime të ndryshme. Në polici ka dhënë deklaratë ndryshe nga mbrojtja e tij në prokurori duke u arsyetuar se nuk ka treguar të vërtetën për shkak të etikës së punës që kryen, nuk ka dashur ti përmendi lokalet me muzikë ku kanë shkuar më dt.09.06.2015.

Në prokurori ka theksuar se më parë nuk e ka njohur Sh. K., por se për herë të parë e ka parë në lokalit “D. M.”, derisa në shqyrtimin gjyqësor tani thekson “se për herë të parë e kam takuar në seancën e hetimeve të veçantë – këtu në gjykatë”.

Deklarimet e tilla të akuzuarit janë orientuar në drejtim të mbrojtjes së tij dhe ikjes nga përgjegjësia penale juridike.

Deklarimet e dëshmitarëve M. K., A. H., F. C. dhe Sh. B., nuk përputhen në mes veti dhe në anën tjetër edhe me deklarimin e të akuzuarit dhënë në prokurori sa i përket kohës së takimit të tyre. Dëshmitarët deklarojnë se janë takuar në bastoren e F. C. rreth orës 19:00 – 20:00, derisa i akuzuari në prokurori ka deklaruar se nga ora 20:00 ka qenë në shoqëri me shokët e tij në bastoren sportive, derisa në shqyrtimin gjyqësor tani deklaron rreth orës 19:00 dhe rreth orës 20:00 me Sh. e kanë dërgu djalin e vëllaut në fshatin S., tani thekson se rreth orës 21:30 minuta, derisa në deklarimet e dëshmitarëve të njëjtit nuk përmendin largimin e tij nga lokali dy herë gjatë natës kritike.

Mospërputhje të dëshmitarëve kemi edhe rreth pretendimit të largimit të Sh. dhe Sh. nga lokali – për ta dërguar punëtorin e Sh. në shtëpi, dhe në anën tjetër edhe me deklarimin e të akuzuarit në prokurori ku ka theksuar se djalin e vëllaut F. ka pas me e qu në shtëpi pas kryerjes së punës në diskotekë, dhe meqë i njëjti është lajmëruar se po shkon me një shok, ai nuk ka shkuar fare në diskotekë, deklaratë kjo që bie ndesh me deklarimin e tij në shqyrtimin gjyqësor ku tani përmend se ka shkuar edhe në diskotekën e tij, ku ka qëndruar rreth 30 minuta.

Në deklarin e dëshmitarës S. A. ajo ka treguar rastin e datës kur ankuesja R. K. ka paraqitur rastin për gjetjen e të dëmtuarës Sh. K., ku ka theksuar fjalët e përdorura të dëmtuarës Sh. në polici – “police, në këtë rast është i involvuar një polic.....se ai polic emrin e ka Sh.”.

Andaj, duke u bazuar në këto prova, i drejtohem trupit gjykues me propozim që të akuzuarin ta shpalli fajtor për veprat penale keqpërdorimi seksual të personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1.1 të KP-së dhe të dënoj sipas ligjit duke marr parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në matjen e dënimit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar M. B. av.Sh. B., ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të paraqitur nga prokurori i shtetit dhe ka parashtruar kërkesë pasurore juridike për vlerën e së cilës do të përcaktohen në kontest civil.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Sh. K. av. R. K. ka deklaruar se e mbështet fjalën përfundimtare të paraqitur nga prokurori i shtetit duke shtuar se në këtë çështje juridike penale ka mjaftë prova për të vërtetuar fajësinë e të akuzuarit dhe për ta shpallur të njëjtin fajtor, gjithashtu ka cekur se ka pasur indicje se të dëmtuarat kanë qenë të shtërnguara për të tërhequr deklarinet e tyre e veqanarisht e dëmtuara Sh. që ka cekur se e falë të akuzuarin, njëherit ka parashtruar kërkesë pasurore juridike për vlerën e së cilës do të përcaktohen në kontest civil.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh. S. av. E. K. në fjalën përfundimtare ka cekur se gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë prove nuk është vërtetuar se i akuzuari Sh. S., ti ketë kryer veprat penale keqpërdorimi seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1.1 të KPRK-së, pasi që një dyshim i tillë deri më tani nuk është vërtetuar, me asnjë provë reale dhe të besueshme.

Mbrojtësi i të akuzuarit iu është referuar dëshmime të të dëmtuarave Sh. K. dhe M. B., dhe kontradiktoritetit të këtyre dëshmime duke cekur mospërputhje të dukshme në deklarinet e tyre të dhëna në stacionin policor dhe deklarinet e tyre të dhëna në mundësinë hetuese të veçantë. Ndërsa duke analizuar dëshminë e dëshmitarëve F. Sh., M. H. dhe Sh. M., mbrojtësi i të akuzuarit ka cekur se këta dëshmitarë në motelet ku kanë punuar asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk ka sjellur ndonjë femër, ndërsa për dëshmitarën R. K. ka cekur se në tërë deklaratën e saj nuk e ka cekur dhe nuk e ka implikuar të akuzuarin. Mbrojtësi më tutje ka elaboruar dëshmitë e dëshmitarëve A. H., M. K., F. C. dhe Sh. B. dhe ka konkluduar se këta dëshmitarë vërtetojnë alibinë se i akuzuari natën kritike tërë kohën ishte në shoqëri me ta nga mbrëmja deri në orët e mëngjesit. Mbrojtësi gjithashtu iu është referuar deklaratës së dëshmitarës S. A. me theks të veçantë dëshminë e kësaj dëshmitare e ka paraqitur jo kredibile dhe tendencioze. Në fund të fjalës së tij përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit ka cekur se nga gjitha provat e administruar është vetëm një deklaratë e të dëmtuarës M. B. andaj ka propozuar gjykatës që në rastin konkret është e pamjaftueshme që vetëm me një deklaratë të merr aktgjykim fajësues. Andaj ka cituar neni 3 të KPP-së, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të Ligjit Penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij, sipas KPP dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe ka propozuar që në bazë të të lartëcekurave të akuzuarin Sh. S. ta liron nga aktakuza konform neni 364 paragraf 1 nënparagraf 1.3 të KPP-së.

Vlerësimi i tezës së paraqitur nga Prokurori i Shtetit

Gjykata në mënyrë të veçantë ka vlerësuar edhe tezën e paraqitur nga Prokurori i shtetit.

Aktakuza e prokurorit të shtetit substancialishtë është bazuar vetëm në deklaratat kontradiktore të dy të dëmtuarave, e të cilat deklarata në fazën e mundësisë së veçantë e relativizojnë tej mase ngjarjen për të cilën ngarkohej zyrtari policor – i akuzuari Sh. S., ato deklarata ishin në kundërshtim të plotë me njëra tjetrën, ndërsa deklarata inkriminuese e të dëmtuarës M. B. e paraqitur fillimisht në polici, ajo dëshminë e saj të dhënë në mundësinë hetuese të veçantë e zhvesh nga argumentet kontekstuale konkrete.

Aktakuza mbështetet edhe në raportin e ekspertizës nga Departamenti për Mjekësi Ligjore, por ky raport nuk ofron më shumë se sa një informatë jo shumë të rëndësishme se gjatë ekzaminimit të e dëmtuara M. B., nuk janë vërejtur dëmtime trupore të jashtme, dhe në ekzaminimin gjinekologjik mjeko ligjor nuk janë konstatuar dëmtime në regjionin perineal dhe anal. Ndërsa nuk janë mbledhur prova biologjike pasi që e dëmtuara i është pastruar, etj..

Ndërsa e dëmtuara Sh. K. nuk ka pranuar fare ti nënshtrohet ekzaminimit gjinekologjik.

Rrjedhimisht me provat të tjera të analizuar si më lartë nuk është arritur të nxjerret ndonjë përfundim që do të vinte në pah ndonjë veprim inkriminues të të akzuarit.

Përfundimisht pas analizimit të fjalës përfundimtare konkludohet se prokurori i shtetit në këtë çështje penale në bazë të provave të ofruara nuk ka arritur të paraqes prova bindëse që do të vërtetonin se i akuzuari ka kryer këto vepra penale për të cilat e ngarkonte aktakuza.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akzuarit dhe mbrojtësit të tij

I akuzuari gjatë rrjedhës së procedurës është deklaruar i pafajshëm, duke theksuar se rasti i është montuar atij, nga personat që nuk ka pasur raporte të mira kolegjiale.

Mbrojtja e paraqitur nga i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor nuk ka qenë e ndërlidhur me deklaratimet tjera të tij të dhëna në procedurën hetimore, i akuzuari në procedurën hetimore jep një version tjetër të ngjarjes me atë të paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, por me arsyetim se për shkak të pozitës së tij si zyrtar policor nuk ka dashur të tregoj detajet se ku ka qenë natën kritike gjegjësishtë qëndrimin e tij në një lokal nate.

Trupi gjykues vlerëson se si do që të jetë paraqitur mbrojtja e të akzuarit, është e padiskutuar se mbi kënd bie barra e të provuarit konform parimeve fundamentale të KPP-së, dhe të nenit 6.2 të KEDNJ andaj nuk është i detyruar që i akuzuari të shfajësoj vetëveten por është detyrë e prokurorit të shtetit të vërtetoj fajësinë e të akzuarit.

Mbrojtja e të akzuarit dhe teza mbrojtëse e paraqitur nga avokati i tij E. K. kanë qenë në të njëjtën vijë, duke shtuar se nuk ka prova bindëse se i akuzuari mund ti ketë kryer këto vepra penale, andaj në mungesë të provave mbrojtja ka propozuar që në këtë rast të merret aktgjykim lirues.

Andaj gjykata vlerëson se teza mbrojtëse e mbrojtësit ishte e bazuar.

Të gjeturat e Gjykatës,

Gjykata gjen si të pakontestueshme faktet si në vijim:

Se të dëmtuarat Sh. K. dhe M. B. ishin nën moshën 16 vjet.

Se të njëjtat ishin njohur në kafiterinë “D. M.” në Suharekë.

Që të dyja ishin larguar nga shtëpitë e tyre për disa ditë me radhë.

Se bashkarisht kishin vendosur që natën kur u njohën gjegjësishtë me dt. 09.06.2015, ta kalonin në motel “V. A.”.

Dhe netët në vazhdim i kishin kaluar në motele të ndryshme kryesisht të rrethit të Suharekës në shoqëri të meshkujve të ndryshëm, deri natën kritike ku të dëmtuarën Sh. e kërkuan familjarët e saj përmes policisë.

Por fakti se i akuzuari Sh. S. ka keqpërdorur seksualisht të dëmtuarat e lartcekura, mbetet vetëm në suaza të dyshimit.

Andaj në bazë të të lartcekuarve trupi gjykues vlerëson se nga administrimi i tërësishëm i provave duke i vlerësuar secilën provë veq e veq dhe në ndërlidhje reciproke me njëra tjetrën nuk është provuar akuzat e Prokurorisë me të cilën pretendohet se i akuzuari Sh. S. ka kryer veprat penale – keqpërdorim seksual i personave nën moshën (16) gjashtëmbëdhjetë vjet, nga neni 235 paragraf 1 nënparagraf 1. 1 të KP-së, andaj në bazë të nenit 364 paragraf 1 nënparagraf 1.3 të KPP-së e liri të akuzuarin nga akuzat.

Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Vendimin me të cilën të dëmtuarat janë udhëzuar në kontest civil gjykata e mori konform nenit 463 paragraf 3 të KPP-së.

Mbi shpenzimet procedurale u vendos duke vepruar konform nenit 454 paragraf 1 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN Departamenti për të Mitur PKR.nr. 133/2015, të dt. 24.06.2016

Procesmbajtëse
Besnike Morina

Kryetare e trupit gjykues
Kymete Kicaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët e pakënaqura kanë të drejtë të paraqesin ankesë në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet kësaj Gjykate.